



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.01.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”” (*Komision përgjegjës*)

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statutore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjiknuri, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Spartak Braho , Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Silva Caka

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj

Të ftuar:

Pandeli Majko – Ministër i Shtetit për Diasporën

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Tomorr Duro – Përfaqësues i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme

Renata Balliu – Shefe Sektori në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi – Specialiste e Sektorit të Marrëveshjes në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Në rendin e ditës kemi dy çështje, shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””. Në shqyrtimin e këtij projektligji komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relator është kolegu Bashkim Fino.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statutoire, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në Republikën e Shqipërisë”. Në shqyrtimin e këtij projektligji jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është kolegja Elena Xhina.

Vazhdojmë me projektligjin e parë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””. Ka konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shtetit për Diasporën, ministri i Shtetit për Diasporën, zoti Pandeli Majko.

Zoti Majko, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Do t’ju lutesha në emër të kolegëve të mi të komisionit për një prezantim të detajuar të këtij projektligji dhe më pas fjalën do t’ia kaloj relatorit të projektligjit, kolegut Fino.

Fjala për ju.

Pandeli Majko – Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””, vjen pas miratimit të disa akteve të rëndësishme, të cilat janë pohuar edhe në rezolutën e fundit të Parlamentit të Shqipërisë për çështjet e reformës dhe të strategjisë për diasporën. Shteti shqiptar aktualisht ka një strategji 2018-2024 për diasporën dhe një plan veprimi lidhur me këtë. Gjithashtu, janë miratuar tre ligje të rëndësishme, falë edhe ndihmës suaj, për një periudhë të shkurtër kohe, siç janë ligji për diasporën, ligji për Fondin e Zhvillimit të Diasporës dhe ligji për Agjencinë Kombëtare të Diasporës.

Janë një varg ndryshimesh në legjislacionin shqiptar, të cilat normalisht kanë kërkuar edhe diskutime të natyrave të ndryshme, për të përfshirë edhe interesat e pushtetit lokal për një komunitet shumë të madh njerëzish, të cilët aktualisht nuk ndodhen në Shqipëri, por që sigurisht komunikojnë, janë të angazhuar, paguajnë edhe taksa, kur bëhet fjalë për taksën e pronës apo ndihmojnë ekonominë e vendit ndërmjet remitançave, që kanë të bëjë me shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë vendit.

Për ta sjellë këtë ndryshim në projektligjin e pushtetit lokal ne jemi angazhuar, fillimisht kemi qenë të kujdesshëm që të mos jetë një hap i njëanshëm, por jemi ulur që përpara verës së kaluar në periudhën qershor-korrik-gusht në takimin e radhës me Këshillin Konsultativ të Pushtetit Lokal. Kemi diskutuar me ta, si dhe me donatorët e interesuar, për ndryshime të natyrave të tilla sa i përket interesave të pushtetit lokal dhe me kënaqësi dëshiroj t'ju them se të gjitha propozimet e tyre, pavarësisht krahëve politikë, janë përfshirë në projektligjin që ju keni përpara.

Është një projektligj që ka pasur edhe konsensusin e të gjithë faktorëve në Këshillin Konsultativ të Pushtetit Lokal. Ndërkaq, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Brendshme, ju kemi lënë kohë të gjithë pushtetarëve lokalë brenda një afati të caktuar për të na dhënë opinione të natyrave të ndryshme, sepse jo të gjithë janë pjesëtarë të Këshillit Konsultativ në Pushtetin Lokal.

Ndryshimet i keni të gjithë përpara. Bëhet fjalë për ndryshimin e nenit 29/1 që është thelbi i ndryshimit, i cili ka të bëjë me krijimin e strukturave të posaçme për diasporën dhe migracionin në administrimin e shërbimeve në nivelin vendor. Fillimisht, edhe pas konsultimeve me pushtetarët lokalë, nuk do të ketë ndonjë kosto financiare. Projektligji është konsultuar, normalisht, nuk mund të kalonte në qeveri në qoftë se nuk do të kishte opinionin e Ministrisë së Financave. Dëshiroj t'ju nënvizoj një fakt shumë të rëndësishëm. Edhe me ndryshimet e legjisllacionit, edhe me strategjinë për diasporën ne po i kthejmë sytë nga një shtresë njerëzish, të cilët për arsye të ndryshme kërkojnë një komunikim të veçantë qoftë nga pushteti lokal, qoftë nga pushteti ekzekutiv. Jo të gjitha çështjet zgjidhen në Tiranë, ka një varg problemesh, informacionesh, metodikash, ndihmash, të cilat pushteti lokal me shumë eficiencë mund t'ia ofrojë kësaj shtrese të gjerë shtetasish të vendit tonë.

Për më tepër, po jua përsëris, Komisioni i Reformës Zgjedhore është përfshirë edhe në diskutime të natyrave shumë të dobishme dhe ka një konsensus, pavarësisht se nuk është rënë dakord për mënyrën se si do të ndodhë nga të gjitha palët politike në Shqipëri për të drejtën e votës. Sigurisht, kjo i takon vendimmarrjes së Komisionit për Reformën Zgjedhore, prandaj në diskutimin tim nuk do të orientohej në këtë drejtim, por mendoj se ajo që jemi duke bërë përfshin pikërisht këtë që ju keni përpara.

Jam i hapur për çdo pyetje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Majko!

Fjalën e ka zoti Fino, si relator i këtij projektligji.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Majko, që jeni i pranishëm sot këtu për këtë projektligj kaq të rëndësishëm!

Nga pikëpamja e bazës kushtetuese projektligji është korrekt. Nga analiza e nenit 81, pika 2 e Kushtetutës dhe përmbajtja konkrete e këtij projektligji rezulton se fusha që rregullon ky projektligj përfshin çështje që i trajton jo kjo dispozitë kushtetuese, por miratimi i një projektligji, që i nënshtrohet një votimi të cilësuar me 3/5-at. Unë do të kisha dashur edhe vëmendjen e opozitës për të qenë prezente dhe për dhënë dakordësinë, sepse preket ligji i pushtetit vendor, i cili është miratuar me 3/5-at.

Qëllimi i projektligjit dhe përmbajtja e tij referuar edhe në relacionin shpjegues apo në ato që sapo na ekspozoi ministri Majko, synon nxitjen e politikave të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të të gjithë shqiptarëve, duke nxitur dhe fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat të shqiptarëve jashtë kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe në shtetet ku ata banojnë, si dhe mbrojtjen e interesave të shtetit.

Siç e tha edhe ministri, në këtë kontekst ky projektligj është në vazhden e tre ligjeve tashmë të miratuara nga parlamenti ynë, ligji “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, ligji “Për diasporën” dhe ligji “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës”.

Projektligji që ju keni përpara përmban tre nene, por neni më kryesor është neni i parë, ku është përcaktimi i funksioneve të bashkive në fushën e diasporës dhe migracionit ku bashkitë parashikojnë edhe përgjegjësit.

Pra, neni 29 “Organet dhe funksionet e pushtetit vendor”, ka të gjitha funksionet që ka bashkia, ndërsa qeveria na ka sjellë një sugjerim që në këtë nen të shtojmë një nen të ri dhe të shtojmë disa funksione të tjera, siç janë: krijimi i një strukture të posaçme për diasporën dhe migracionin; nxitja e organizatave brenda dhe jashtë vendit për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm; dhënia e ndihmës së informacionit për çështje që lidhen me regjistrimin e fitimit të shtetësisë; dhënia e ndihmës së informacionit për legjislacionin shqiptar në fuqi dhe koordinimin e bashkëpunimin e punës për ministrinë përgjegjëse, punët e brendshme, punët e jashtme dhe për diasporën.

Neni 2, është shtimi i përfaqësive të diasporës si kategori, nëpërmjet të cilës zhvillohet procesi i konsultimit i qeverisjes vendore.

Neni 3, ndryshimi i afatit të dispozitave të raportit të veprimtarisë financiare dhe zbatimit të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore në këtë këshill.

I lexova këto tre nene, sepse unë kam fatin të jem edhe hartuesi i projektligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor. Tani do filloj të diskutoj disa çështje, pasi

në thelb ky është një projektligj i domosdoshëm, por mund të zgjidhej apo neutralizohet edhe me akte të tjera nënligjore. Në ligjin e diasporës, edhe propozimi që ka ardhur nuk përbën ndonjë gjë të jashtëzakonshme, por vetëm duhet të jemi të kujdesshëm kur ndërhyjmë në ligje që kërkojnë 3/5-at, sepse ka momente, të cilat, zoti Majko, i ka sjellë të kuadratura për fushën e vet, por në fushën e ligjit të organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor ne mund të kemi edhe probleme të tjera, qoftë ne apo opozita për të cilat duam të bëjmë ndryshime.

Gjithsesi, një çështje që kërkon diskutim, për të cilën do të doja vëmendjen e ministrit Majko, por në mënyrë të veçantë të kolegëve, pasi në parim jam dakord me këtë projektligj, është se në nenin 22 të këtij ligji përcaktohet parimi se si ushtrohen funksionet e njësive të qeverisjes vendore, duke njohur të drejtën e ushtrimit të plotë dhe mënyrën e pavarur të funksioneve që u njihen me Kushtetutë, si dhe ligjet e qeverisjes vendore, por duke respektuar, gjithashtu, kuadrin më të gjerë të politikave kombëtare rajonale.

Në këtë aspekt, nga neni 23 deri në nenin 29 të ligjit aktual të vetëqeverisjes vendore janë përcaktuar kompetencat e njësive të qeverisjes vendore. Çfarë janë kompetencat? Kompetenca janë: kompetencë për infrastrukturën; kompetencë për furnizimin me ujë, për kanalizimet, administrimin e mbetjeve urbane, planifikimin dhe kontrollin e territorit, shërbimet sociale, kulturën, shërbimet argëtuese, si dhe shërbime në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Këto janë të gjitha funksionet që ka qeverisja vendore, kryetari i bashkisë dhe këshilli përkatës.

Njësive vendore në këto raste u është akorduar si e drejtë për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e funksionit ashtu edhe të drejtat për të përcaktuar rregullat dhe standardet e detyrueshme në përputhje me ligjin.

Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, decentralizimi është një proces, ku autoriteti dhe përgjegjësia për funksione të caktuara transferohen nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore. Në themel të decentralizimit qëndron parimi i subsidiaritetit, sipas së cilit: “Ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet në mënyrë të përditshme t’u takojë më tepër autoriteteve që janë më afër qytetarëve”. Ky parim shumë i rëndësishëm i sanksionuar edhe në Kartën Europiane të Autonomisë Vendore është marrë në konsideratë në përcaktimin e funksioneve të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe në ligjit aktual nr. 139/2015 “Për qeverisjen vendore”.

Në fushën e diasporës, sipas propozimit të paraqitur, por edhe shpjegimeve të dhëna në relacion, ku argumentohet se ky projektligj vjen si një propozim në kuadër të masave të vazhdueshme të qeverisë shqiptare për ngritjen e infrastrukturës institucionale, për zhvillimin

e lidhjeve me diasporën, me propozime në vazhdim të paketës së akteve rregullatore, të akteve ligjore në fushën e diasporës, vërejmë se:

a. Në referencë të parimit të subsidiaritetit, ushtrimi i përgjegjësiwe publike duhet në mënyrë të përgjithshme t'u takojë më tepër autoriteteve më afërta të qytetarëve. Njëkohësisht me ligjin për diasporën, janë parashikuar organet shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën. Në referim të këtij ligji, por edhe në kuadrin ligjor të miratuar në fushën e diasporës, përfshirë këtu edhe strategjinë kombëtare të diasporës 2018-2024, konstatojmë se njësitë e qeverisjes vendore nuk janë parashikuar si institucione përgjegjëse në fushën e marrëdhënieve me diasporën. Ky është një gabim, sepse duhej të ishin parashikuar që te ligji për diasporën.

Atëherë, me të drejtë lind një pyetje, e cila dua të jetë në vëmendjen e ministrit. Cilat janë kriteret që janë mbajtur në konsideratë për të vlerësuar dhënien e kompetencave të njësiwe vendore në fushën e diasporës dhe a është bërë një analizë e impaktit që do të ketë ky propozim, duke marrë në konsideratë raportin kosto-përfitim?

Ti u thua sot që merreni, pra u delegojmë një kompetencë dhe u themi që duhet të bësh këtë gjë

b. Ushtrimi i disa prej kompetencave të propozuara për t'u ushtruar nga njësitë e qeverisjes vendore kërkon angazhimin e tyre jashtë vendit, ndërkohë që ligji i vetëqeverisjes vendore ka parashikuar në mënyrë eksplicite që objekti i rregullimit është organizimi dhe funksionimi i njësiwe të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, pra brenda territorit të bashkisë (neni 1 i ligjit).

Pyetja tjetër: Si është vlerësuar ushtrimi i këtyre kompetencave nga njësitë e qeverisjes vendore? Unë mund të zgjidhem kryetar bashkie në Tiranë, në Lushnjë, në Tropojë, në Shkodër, në Korçë për të drejtuar atë njësi vendore. Unë nuk zgjidhem që të ushtrojë detyra jashtë territorit për të cilin jam zgjedhur.

c. A janë vlerësuar këto propozime në raport me ligjet e tjera në fuqi si ligji "Për gjendjen civile" (dua ta theksoj fort këtë për ligjin e gjendjes civile), ligji "Për diasporën", ligji "Për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve"? Një pjesë e funksioneve të propozuara për t'iu akorduar njësiwe vendore ushtrohet aktualisht nga institucionet shtetërore bazuar në ligjet e posaçme. Konkretisht, dhënia e një informacioni për çështje që lidhen me regjistrimin e fitimit të shtetësisë është çështje që rregullohet vetëm me ligjin e gjendjes civile, nuk kanë lidhje organet dhe funksionet e pushtetit vendor. Ne kemi një ligj të gjendjes civile dhe vetëm ai ligj me nr. 10129/2009 "Për gjendjen civile" është ligji që rregullon fitimin e shtetësisë. Pra, fjala është që banorë të caktuar, që janë jashtë territorit tonë, në

Kanada, Gjermani, Amerikë, fëmijët e tyre që kanë lindur atje, duhet të marrin shtetësinë dhe këtë shtetësi ata e marrin vetëm nëpërmjet ligjit të gjendjes civile, por jo duke e shkruar dhe duke e vënë në këtë projektligj.

ç. Propozimi parashikon detyrimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për ngritjen e strukturës së posaçme për diasporën. Këtu nuk shoh ndonjë gjë të keqe, sepse kjo mund të jetë bërë edhe me një urdhër, edhe me vendim qeverie, për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore. Ky funksion shoqërohet me kosto financiare për bashkitë, ndërsa këtu thuhet se nuk ka kosto financiare. Pra, duhet t'u themi kryetarëve të bashkive dhe këshillave përkatëse të ngrenë një zyrë për diasporën pranë bashkive dhe kjo do të jetë diçka shumë e mirë, është një gjë e jashtëzakonshme që duhet vërtet. Ata mund të kenë resurse për ta bërë një gjë të tillë edhe brenda strukturës që kanë dhe unë jam që ta kenë absolutisht, por që t'i urdhërojmë me një ligj këto organe të pushtetit vendor dhe t'u themi që duhet ta kesh këtë zyrë pa u dërguar asnjë fond financiar dhe asnjë numër punonjësish, kjo mua më duket ndërhyrje në kompetencat e organeve të pushtetit vendor. Ne kemi thënë se ata janë të pavarur, janë në funksion me qeverinë, me buxhetin, vetëm thjesht për buxhetin e pakushtëzuar, gjithë të ardhurat e tjera i krijojnë vetë. Unë vlerësoj se duhet të shpjegohet nëse shtimi i këtyre përgjegjësive është i përballueshëm në aspektin financiar me buxhetin aktual të njësive të qeverisjes vendore. Unë mendoj se është, po të më pyesësh si ekspert i fushës, por edhe si ish-kryetar bashkie, sepse brenda administratës që kam mund ta përballoj. Gjithsesi, kur vendoset me ligj dhe i thua se do ta kesh me detyrim këtë gjë dhe vendoset, kjo është me 3/5-at, është një ligj shumë i rëndësishëm, do të thotë se ai është i detyruar ta ketë nesër në strukturë, organi i pushtetit vendor, bashkia përkatëse.

Së dyti, në bazë të nenit 12 të ligjit aktual nr. 139/2015 të qeverisjes vendore, bëhen konsultime me njësitë e vetëqeverisjes vendore për politikën, legjislacionin, normat që rregullojnë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të këtyre njësive. Pyetja ime është: a është zhvilluar një proces konsultimi me shoqatat përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore, me grupet e interesit, me Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore, me vetëqeverisjen vendore dhe si janë adresuar komentet e paraqitura prej tyre në këtë projektligj? Neve na kërkohet, do ta shohim në një nen më poshtë, që diaspora të jetë grup interesi për bashkitë nesër, kur të marrin vendim, ndërkohë që bashkive u japim një detyrë dhe nuk e di nëse i kemi pyetur apo nuk i kemi pyetur.

Së treti, nisma ligjore parashikon që përfaqësuesit e diasporës të përfshihen, atë që thashë pak më lartë, në mënyrë të shprehur në kategorinë e subjekteve nëpërmjet të cilave

njësitë e vetëqeverisjes vendore të konsultohen për propozimet e tyre, për politikat dhe legjislacionin që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ushtrimin e të drejtave dhe funksioneve të tyre. Këtë propozim e gjejmë të paargumentuar. Çfarë themi ne? Ne themi, në ligj, na është propozuar, që një grup interesi do të quhet diaspora. E zëmë se unë jam kryetari i bashkisë së Lushnjës apo i Gjirokastrës. Duhet që, kur të diskutoj një projektligj, një vendimmarrje, natyrisht do të pyes qytetarët e Gjirokastrës, ai është grupi i interesit në fund të fundit. Ndërsa ligji tani më thotë se ti duhet të pyesësh të gjithë diasporën gjirokastrite, që është anëmbanë botës, duhet të vijnë edhe ata atje, të të japim mendime e të tjera, ndërkohë që unë drejtoj në Gjirokastrë, nuk drejtoj në Kanada, nuk drejtoj në Gjermani, nuk drejtoj në Greqi apo në Itali. Këta thonë që jo, ata duhet të jenë grupe interesi. Prandaj, aktualisht, referuar ligjit nr. 16/2018 “Për diasporën”, është parashikuar ngritja e një organi përfaqësues dhe koordinues të marrëdhënieve me diasporën që është Këshilli Kombëtar i Diasporës. Pra, ne e kemi organizuar me ligjin e diasporës, në përbërje të të cilët ka përfaqësues të diasporës. Deri këtu jemi në rregull.

b. Ligji parashikon konsultimin e nismave, politikave dhe legjislacionit që ka ndikim në funksionet e qeverisjes vendore me shoqatat përfaqësuese të vetë njësive, duke marrë në konsideratë pikërisht të drejtën e njësive të qeverisjes vendore për t’u organizuar në shoqata. Lind pyetja, në këtë rast, a mund të konsiderohen përfaqësuesit e diasporës, si përfaqësues të interesave të njësive të qeverisjes vendore? Është një pyetje shumë thelbësore kjo. A mundet që të konsiderohen përfaqësuesit e diasporës përfaqësues të interesave të qeverisjes vendore për t’u identifikuar si grupe interesi më vete?

Unë mendoj se nuk është kështu.

Po vij te pika e fundit që kam, kjo është teknike, besoj se do më mirëkuptojë edhe ministri, por edhe kolegët. Është fjala për nenin e fundit. Neni i fundit është neni 3 dhe në të thuhet: “Në nenin 44 fjalët “31 mars” zëvendësohet me fjalën “31 maj”. E dini se çfarë është kjo, të nderuar kolegë, sepse unë e njoh mirë pushtetin vendor mirë? Kjo është që më 31 mars kemi miratuar me ligjin e organeve të pushtetit vendor me 3/5, raportimin që bën kryetari i bashkisë në këshillin e bashkisë për buxhetin faktik të vitit që kaloi, jo për projektbuxhetin. Në këtë ligj kemi thënë: “Kryetari i bashkisë ka të drejtë të informojë këshillin përkatës brenda 31 marsit për buxhetin faktik”. Këta tani në këtë ligj na kërkojnë, edhe miratimi i këtij ligji bëhet me 3/5-t, që 31 marsi të zëvendësohet me 31 majin. Pra, raportimi financiar për të marrë pjesë edhe diaspora. Në fakt, po ta lexosh me vëmendje, kam hapur disa ligje dhe i kam këtu: çfarë kanë përfituar me këto që kanë paraqitur?

Para disa kohësh është miratuar ligji për financat lokale, i cili, për fat të keq, nuk ka kaluar këtu, ku ka një nënkomision të pushtetit vendor, por ka kaluar vetëm në Komisionin e Ekonomisë. Në këtë komision është kaluar data 31 maj me ligjin e financave lokale, si datë për të bërë këtë ekspozë kryetari i bashkisë në këshillin përkatës. Ky është një ligj me 3/5-t, i cili prevalon në raport me ligjin për financat lokale, sepse është një ligj i cilësuar. Në qoftë se ne bëjmë këtë ndryshim, që mua më duket absurd, nuk ka asnjë lloj problemi, sepse më 31 mars duhet të diskutohet patjetër buxheti faktik, sepse mbas muajit maj fillon projektbuxheti i ri që përgatit këshilli dhe kryetari i bashkisë. Edhe kjo më duket nonsens për të qëndruar këtu. Por kjo është një çështje që mund të diskutohet.

Për të dalë në konkluzion, zoti kryetar, zoti Ministër, dua t'ju them se nisma është gjë shumë e mirë, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, pavarësisht pyetjeve dhe sugjerimeve teknike, por edhe profesionale. Këtë ia lejoj vetes ta them para se ta thoni ju, te ligji i pushtetit vendor ka mospërputhje, të cilat mund të rregullohen dhe ka mundësi për t'i rregulluar shumë mirë. Do të propozoja, zoti kryetar, që, pasi të dëgjonim edhe përgjigjet e zotit Majko, apo edhe diskutimet e kolegëve, ky projektligj të kalojë në parim. Duhet t'i lëmë kohë edhe opozitës që ta shikojë në mënyrë korrekte dhe shumë dashamirëse, në kuptimin e mirë të fjalës, sepse është një ligj i cili kërkon maksimalisht 140 vota, ajo kërkon 3/5, 84 vota, por është një ligj që ne gjithmonë e kemi bërë në konsultim të plotë me opozitën dhe asnjëherë nuk kemi tentuar të miratojmë një ligj të tillë për organet e pushtetit vendor pa miratimin e saj. Në momentin që ndërhyjmë për disa nene për diasporën, natyrisht do të dëshiroja të ishte opozita gjatë ndryshimeve nen për nen për ta votuar dhe për ta miratuar me 3/5-t, në të kundërt, kjo do të ngelet në letër, sepse nuk mund të kalohet me 3/5-t dhe ne nuk mund të pengohemi. Këtë po ia them opozitës edhe tani, sepse, fare mirë, ajo që thashë më parë, zoti Majko, mund të bëhet me një urdhër apo vendim qeverie për të ngarkuar organet e pushtetit vendor e për të thënë që kemi edhe një kompetencë tjetër të merremi me diasporën. Unë e thashë edhe në fillim të diskutimit tim që mundësitë e bashkive janë për të pasur 1 apo 2 veta që merren me diasporën edhe sikur të mos shtojmë numër punonjësish apo mundësi financiare tek organet e pushteti vendor.

Ju faleminderit për vëmendjen!

(Shyqyr që sot nuk m'u hidhërua i famshmi, Adnori!)

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e ka zoti Majko, për t'iu përgjigjur zotit Fino dhe më pas kolegët e tjerë.

Pandeli Majko – Të nderuar kolegë,

Mendoj se pyetjet që ngriti zoti Fino janë mjaft të drejta dhe meritojnë vëmendje. Dua ta them pa filluar përgjigjet, që jam i hapur për çfarëdolloj ndryshimi konstruktiv edhe në funksion të votës së opozitës, pasi është një projektligj, i cili do të kërkojë votat e 3/5-ve me shumicë të cilësuar të Kuvendit.

Po e filloj nga pyetja pse nuk u bënë ndryshimet që në ligjin e diasporës. Nuk u bënë, sepse menduam që ligji i pushtetit lokal është një ligj me shumicë të cilësuar, i cili prevalon në çdo rast. Në fakt, nuk vjen thjesht si propozim i ministrit të Shtetit, se duket që është jashtë kontekstit dhe propozimeve të mia, por vjen si propozim, sepse kur projektligji kalon nëpër ministri të ndryshme, ku secila ka të drejtën të propozojë, vjen si rregullim ligjor që është në tagrin tuaj si Komision i Ligjeve ta vlerësoni. Duket që ka pasur një inkonsekuencë në trajtimin që kur është bërë ndryshimi i parë, unë nuk mund të ndërhyj në këtë drejtim, pasi, duke pasur një eksperiencë modeste, e di që fjala e Komisionit të Ligjeve është prealuesë mbi çdo gjë tjetër për sa i përket teknikës ligjore.

Sa i përket çështjes së konsultimeve me pushtetin lokal, jua thashë edhe në fillim, por dëshiroj ta përsëris, ne kemi bërë një konsultim të kujdesshëm që para verës së vitit të kaluar, kemi bashkëpunuar edhe me agjencitë e interesuara për reformën e pushtetit lokal, kemi kërkuar opinionet e të gjithë pushtetarëve lokalë lidhur me këtë çështje. Mund ta bënim edhe me një vendim qeverie, siç tha me të drejtë edhe zoti Fino, por, duke qenë se ofrojmë një fushë të re shërbimesh, menduam se kjo do të ishte gjëja më e mirë që të mos e mbingarkojmë marrëdhënien e ekzekutivit me pushtetin lokal, për më tepër kur për këtë çështje ekziston një konsensus i mirëkuptueshëm nga të gjitha palët. E përsëris me kënaqësi, që në këshillin konsultativ, ku kam qenë me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe atë të Drejtësisë, opinionin e të gjithë përfaqësuesve të pushtetit lokal në këtë këshill, të majtë apo të djathtë, ishte përkrahës lidhur me këtë çështje.

Është një fenomen administrativ i ri që ka filluar që me ndryshimet legjislativë që ju citova dhe i përsëriti edhe zoti Fino, të cilave duhet t'u përgjigjemi pasi kemi të bëjmë me një komunitet njerëzish, shtetasish, të cilët janë të interesuar. Puna e konsultimit duhet të shikohet me të drejtë. Teknikisht mund të krijojë probleme të natyrave, të cilat kanë të bëjnë me teknikën dhe praktikën burokratike. Ç'do të thotë kjo? Konsultim nuk do të thotë të shkosh deri ku është gjirokastriti i fundit, po flas për Bashkinë e Gjirokastrës, apo ai i Tiranës për Bashkinë e Tiranës e kështu me radhë, besoj se këtu ka vend për t'u parë që të mos kemi ngecje të çuditshme apo interpretime të natyrave konfuze, më pas në bashki të ndryshme në mënyra të ndryshme. Kështu që këtë fakt dëshiroj ta nënvizoj.

Për sa i përket çështjes së fondeve, ne e kemi diskutuar edhe me përfaqësues të pushtetit lokal. Për fazën e parë, kjo do të jetë një kategori shërbimesh, pasi një pjesë e njerëzve vijnë për natyra të ndryshme problemesh, po e them pa dashur të bëj ndonjë shprehje letrare “ndjehen të huaj në vendin e tyre” dhe duan një zyrë apo një *road mape* të zyrave të politikës administrative të shtetit shqiptar ku ata të ndjehen komodë dhe të marrin informacionin e duhur. Në disa raste vijnë me një kulturë tjetër. Tani po rritet brezi i dytë i migracionit, një pjesë e tyre dëshirojnë të kthehen në vend për të hapur një biznes dhe është e natyrshme që shtetit shqiptar t’u përgjigjet në këtë mënyrë. Nuk po bëjmë shpikje, por po ndërtojmë një model, i cili funksionon në vende të tjera me migracion të zhvilluar, siç është vendi ynë. Migracioni dhe Diaspora është cilësi kombëtare e shoqërisë sonë , kështu që ne duhet t’u përgjigjemi edhe nga pikëpamja e kulturës administrative.

E përsëris, i vlerësoj absolutisht jo vetëm si opinionet e një kolegu, por edhe si opinionet e një eksperti ato që tha zoti Fino. Jam i hapur për çdo lloj bashkëpunimi dhe ndryshimi në këtë drejtim.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Majko!

Ka pyetje nga kolegët? Fjala për zotin Mediu.

Fatmir Mediu – Zoti Majko, nisur edhe nga kjo që thatë së fundi, që shumica e shqiptarëve që janë në emigracion, që tentojnë të krijojnë një marrëdhënie me Shqipërinë, me familjet e tyre, por edhe për nevojat e tyre, ndjehen të huaj në vendin e tyre, a ka një analizë të qartë ministria juaj për sa u përket kategorive shoqërore të atyre që kanë emigruar, moshës, edukimit, në raport me atë çka ka mbetur në Shqipëri sot? Duke qenë se përfaqësoni Ministrinë e Migracionit, si e shikoni këtë largim masiv, jo vetëm se ndjehen të huaj, por ndjehen të pamundur për të ndërtuar atë çka duhet në vendin e tyre për shkak të politikave në qeverisje? Si duhet menaxhuar kjo marrëdhënie për të ndaluar këtë fluks emigracioni, i cili, në gjykimin tim, është i tmerrshëm për të ardhmen e vendit tonë?

Pandeli Majko – Me qëllim që informacione të natyrave të tilla të mos i trajtojmë si fenomene të politizuara, jemi duke bashkëpunuar me disa ekipe studimore, të cilat i kanë publikuar së fundi, sidomos më i veçanti dhe që ne duam ta kthejmë në vjetor, është ai i Institutit të Statistikave, që mund të konsiderohet, po e quaj, si fenomen shtetëror.

Fondacioni “*Friedrich Ebert*” ka bërë një studim lidhur me këtë çështje. Ne jemi duke studiuar jo me logjikën cili ka ikur e cili ka mbetur, por mendojmë se shteti shqiptar duhet të gjejë dhe po ndërton një politikë të re shtetërore jo vetëm për të bërë matematikën e atyre që e lënë këtë vend, por edhe për t’iu dhënë mundësi atyre që dëshirojnë të kthehen. Ju

siguroj që, siç ka njerëz që për mundësi më të mira largohen nga vendi, ka edhe njerëz të tjerë që janë të interesuar të kthehen. Gjithsesi, besoj se ky fenomen është i natyrshëm...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk po flas për sirianët, dhe nuk po bëj shaka për këtë çështje!

Shqiptarët janë larguar edhe më parë, zonjë, edhe kur kemi qenë në koalicion së bashku, dhe nuk kanë qenë sirianët ata që kanë prevaluar. Është vendimmarrja e shqiptarëve të lëvizin të lirë, është e drejtë kushtetuese në Shqipëri. Siç kanë të drejtë kushtetuese të lëvizin nga fshati në qytet, ashtu kanë të drejtë të lëvizin nga qyteti jashtë vendit.

Sigurisht, jemi duke ndërtuar politika të reja shtetërore të shqetësuar për këtë çështje dhe besoj se kjo që po diskutojmë sot ofron mundësi shumë herë më të mira për ata njerëz që janë të interesuar për problemet e regjistrimit dhe për problemet e investimit në vendlindjen e tyre. E thashë edhe pak më parë që jo të gjitha gjërat zgjidhen në Tiranë, një pjesë e tyre, e cilësisë së shërbimeve, zgjidhen në pushtetin lokal. Kështu që besoj dhe uroj që ky ndryshim të krijojë këtë lloj impakti të njerëzit, mbi të gjitha në mënyrë të dukshme kujdesin që ne kemi për ta.

Ata që kanë ikur nuk kanë thënë ndonjëherë që do të ikin përgjithmonë. Ata e kanë kokën pas gjithmonë, por ne duhet të jemi të gatshëm që në momentin që kthehen, të mos ndodhemi, siç ndodhi në rastin e krizës ekonomike greke, kur erdhën mbi 120 mijë veta dhe një pjesë e madhe e tyre u larguan sërish, sepse edhe një pjesë e strukturave tona shtetërore, duke filluar nga ato arsimoret, ishin të papërgatitura. Ndaj, këto pësime do të na bëhen mësim. Nuk po them që këtu dielli ndriçon 24 orë dhe të gjitha gjërat janë duke shkuar mirë, por mendoj që ne po i përgjigjemi kësaj cilësie të re. A jemi vonë? Po, jemi vonë, e kemi thënë nga mëngjesi deri në darkë këtë dhe po përpiqemi të vrapojmë, jo të ecim, për sa u përket ndryshimeve në këtë drejtim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Majko!

Fjala për zonjën Caka.

Silva Caka – Faleminderit!

Po përfitoj nga rasti, meqë vet ministri është prezent dhe jo një përfaqësues i ministrisë, që të bëj një pyetje lidhur me nenin 29, germa “b”, ku parashikohet nxitja e organizimeve brenda dhe jashtë vendit për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm dhe forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë. Përpara se të referoj pyetjen, do t’i referohem edhe një herë fjalës suaj, zoti Ministër, kur folët në lidhje me gjithë marrëdhënien që diaspora dhe emigrantët krijojnë me vendin e tyre duke filluar që nga pagesa e taksave, në rastet e pronës e të tjera me radhë dhe, për dëshirën e qeverive të ndryshme, jo

vetëm tuajën, që t'i bëjnë emigrantët tanë, apo diasporën pjesë të procesit tonë zgjedhor. Pra, duke pranuar edhe detyrimet që ata kanë ndaj shtetit shqiptar dhe duke u përpjekur të gjithë bashkë t'u krijojmë mundësinë e shprehjes së vullnetit zgjedhor.

Shumë bukur mund ta formulojë pyetjen duke pyetur se sa hipokrit është ky projektligj apo sa hipokrite është kjo qeveri, por do t'i referohem vetëm kësaj pike dhe do t'ju bëj vetëm një pyetje: ju, si ministër i Diasporës, në nxitjen e organizimeve brenda dhe jashtë vendit në lidhje me protestën që u paralajmërua dhjetorin e kaluar, dhe që u refuzua nga strukturat e qeverisë ku edhe ju bëni pjesë, keni pasur ndonjë komunikim dhe a është marrë në konsideratë mendimi juaj për ta refuzuar këtë protestë, e cila, e cilësoj sërish, ishte një protestë e shprehur nga organizatorët si një protestë paqësore? Keni pasur një rol qoftë edhe minimal në vendimmarrjen që iu refuzua?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është ministër, sigurisht që ka lidhje! Ka lidhje edhe me projektligjet.

(Deputetja Caka flet pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Silva Caka – Më falni, a mund ta bëj edhe një herë pyetjen, se paska qenë pa mikrofon?

Ulsi Manja – Jo, në rregull është!

Zoti Majko, fjala për ju.

Pandeli Majko – Mendoj se germa “b” “Për nxitjen e organizimeve brenda dhe jashtë vendit” është thjesht njohje nga pikëpamja ligjore e marrëdhënieve që duhet të kenë pushtetarët lokalë me organizimet e ndryshme, të cilat në përgjithësi janë të orientuara edhe nga momenti i identitetit të prejardhjes. Ka shumë nga vendet pritëse, që shpesh janë të organizuara mbi bazën e krahinave dhe besoj se kjo nuk ka asgjë të keqe edhe në kuptimin nxitës të mirë të fjalës, pasi elemente të natyrave të tilla vetëm do të forcojnë marrëdhëniet e komuniteteve me interesat e vendlindjes.

Për më tepër, përbën një interes të shtuar të njerëzve që janë jashtë vendit, pasi në themi “Atdheu-Atdheu”, por atdheu fillon nga shtëpia, nga zona ku ke lindur e je rritur dhe nga prejardhja e prindërve. Mendoj se organizime të natyrave të tilla janë të mirëpritura dhe funksionojnë mbi bazën e modeleve ekzistuese që organizojnë edhe shtetet e tjera që kanë migracion të zhvilluar si Shqipëria. Ajo që dëshiroj të nënvizoj është fakti që pushtetarët lokalë, në kushtet kur diskutohet edhe e drejta e votës, do ta kenë të natyrshme...

Me shumë të drejtë kolegu Fino ngriti problemin e projektligjit për funksionimin e ligjit të shtetësisë. Aktualisht grupi i punës e ka mbaruar ligjin e ri të shtetësisë dhe besoj se

shumë shpejt do të kalojë në qeveri dhe do të vijë të diskutohet në Komisionin e Ligjeve, ku edhe ne kemi bërë propozimet tona. Janë një varg ndryshimesh në legjislacion, në kuptimin më të mirë të fjalës, në të gjithë skemën e komunikimit të shtetasve tanë jashtë vendit me administratën shqiptare, të cilat janë duke u ndryshuar. Në fund fare, ne si politikë duhet t'u përgjigjemi interesave të qytetarëve tanë që nuk jetojnë në vend dhe për arsye të ndryshme janë jashtë vendit.

Për sa i përket protestës, mendoj se ajo është e njerëzve të lirë, që kanë të drejtë të dalin para Kryeministrit e të kërkojnë rrëzimin e qeverisë. Diaspora nuk është subjekt, as ombrellë as e së djathtës dhe as e së majtës. Keqinterpretime të natyrës - “Ku ishit ju? Pse nuk vajtët? Pse nuk bëtë?”, nuk mendoj se i takojnë diskutimit të sotëm të projektligjit, por mendoj se konteksti i protestave të ndryshme nuk duhet ndarë në ata që vijnë nga diaspora dhe ata që jetojnë në Shqipëri. Çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, brenda apo jashtë vendit, për 1 mijë arsye e veta që mund të ketë, ka të drejtë të protestojë jo vetëm para Kryeministrit, por edhe para ambasadës, në qoftë se i preken interesat e veta. Ndaj, nuk ka pse të bëhen pyetje aluduese “ku, si, pse”, është e drejtë kushtetuese e tyre.

Ulsi Manja – Ka pyetje të tjera?

Silva Caka – Zoti Majko, të drejtën për të protestuar dhe ligjshmërinë e protestës sigurisht, nuk ia vendosni dot askujt. Edhe hipokrizia e qeverisë suaj, me përgjigjen që sapo kthyer u verifikua që nga 1 deri te 10, qenka 11.

Pyetja ime ishte shumë e qartë: ju, si përfaqësues i qeverisë për interesat e njerëzve që nuk jetojnë sot në Shqipëri, a keni pasur komunikim me drejtorinë specifike, për sa i përket refuzimit të protestës?

Pandeli Majko – Zonja Caka, jemi kolegë, ju njoh prej një periudhe relativisht të gjatë dhe kam një respekt të veçantë për ju dhe familjen tuaj!

Mendoj se hipokrizia është një problem këndvështrimi. Me sinqeritet do t'ju them se do të tregohesha shumë hipokrit nëse do të tentoja të takoja njerëz që kërkonin rrëzimin e qeverisë ku bëj pjesë, dhe të bëja burrin e mirë duke lënë kolegët e mi pas krahëve. Mendoj se çdo qytetar ka të drejtë të protestojë për rrëzimin e qeverisë dhe mendoj që çështja e hipokrizisë në politikë është një temë shumë e gjerë për t'u diskutuar sot, kur ne po diskutojmë ndryshimin e ligjit të pushtetit lokal.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Majko!

Fjala për zotin Naço.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Dua ta falënderoj ministrin për prezencën në komision! Është ndër të rrallët ministra që vjen, sepse zakonisht të tjerët dërgojnë zëvendësin ose drejtorin përkatës.

Së pari, lidhur me projektligjin, nuk dua t'i heq asgjë oponencës konstruktive që bëri zoti Fino. E thënë me dy fjalë, nëse do të isha unë në vend të zotit Fino nuk do të mundesha ta rrëzoja projektligjin si ai, me dëshirën e mirë për ta përmirësuar. Jo se donte ta rrëzonte, por e kishte bërë në mënyrë analitike. Si ekspert i kësaj fushe pyetjet e mia janë të thjeshta, zoti Ministër. Ju kërkoni nëpërmjet projektligjit që përfaqësuesit e bashkisë të bëjnë takime me grupet e interesit dhe me përfaqësuesit e diasporës, por në relacionin prej gjysmë faqeje që unë kam mbi tavolinë, nuk flitet në asnjë rresht që ju keni kontaktuar, keni diskutuar me grupet e interesit që janë në bashki. Nëse e keni bërë, nuk është faji juaj, por, kur është zbardhur nga kryeministria dhe ka ardhur në Komisionin e Ligjeve nuk janë vënë të gjitha takimet që ju keni bërë, pra nuk janë pasqyruar në relacion. Ju i keni bërë dhe nuk i kanë sjellë nga kryeministria apo nuk i keni bërë dhe u kërkoni të tjerëve që të bëjnë takime me grupet e interesit?

Së dyti, kërkohet, edhe sipas Kushtetutës, nëse kemi një shifër të saktë, zoti Majko, sa është numri i shqiptarëve sot në botë? Nuk e dua me presje dhjetore, por të përafërt, sepse nuk besoj se e keni të përcaktuar qartë sa është, por që ta dimë ne dhe qytetarët sa shqiptarë janë sot në Shqipëri dhe sa janë jashtë. Ju po përgatitni një projektligj dhe në relacion duhej pasqyruar rëndësia. Relacioni ka vetëm gjysmë faqeje.

Ju në relacion, edhe zoti Fino e përmendi, nuk parashikoni kosto në buxhetin e bashkive. Po marr germën “a”, “Krijimin e strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore”. Duke qenë se në relacion nuk pasqyroni asgjë rreth kësaj germe, a mund të na i shpjegoni më qartë se ç’formë është kjo germë “a” e këtij ligji dhe se çfarë detyre do të ketë kjo strukturë?

Për germën “b” ju pyeti Silva, unë po vazhdoj te germa “c”, “Dhënia e ndihmës së informacionit për çështje që lidhen me regjistrimin për fitimin e shtetësisë”. Si do ta bëjë kjo strukturë?

Germa “d” është në projektligj, por nuk është në relacion. Po të ishte në relacion, nuk do t'i bëja pyetjet, por, me sa duket, relacionit i kanë hequr ndonjë fletë rrugës, se nuk ka mundësi të vinte gjysmë faqeje, ose duhet të kërkoni shtesë në organikë që ta plotësoni ministrinë tuaj dhe të vijë projektligji i plotë, sugjerimi im është ky. Për germën “d” “Koordinimi dhe bashkëveprimi i punës me ministritë përgjegjëse: për Punët e Brendshme, Punët e Jashtme, për Diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës së informacionit për

çështje që lidhen me diasporën dhe migracionin”, duke qenë se nuk është në relacion. Çfarë se si e mendoni ju, që e keni sjellë këtë projektligj? Ta dëgjojmë ne, ta dëgjojnë edhe qytetarët, por na kërkohet ne që do ta votojmë na kërkohet një herë në parim. Ligji është qëllimshëm, është dëshirë e mirë juaja, por i mungon pjesa arsyetuese.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Po, zoti Fino.

Bashkim Fino- Këtu kam ligjin e pushtetit vendor, i cili është bërë me 3/5-tat, e ka votuar edhe zoti Naço. Nga neni 23 deri te neni 29, siç e shpjegova, janë funksionet e bashkive në fusha të ndryshme dhe fillon me radhë: neni 23 “Funksionet në fushën e infrastrukturës të shërbimit publik”; neni 24 “Funksionet në fushën e shërbimit social”; “Funksionet e bashkive në fushën e sportit dhe shërbimeve argëtuese”; neni 26 “Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit”; neni 28 “Funksionet e bashkive në fushën e zhvillimit ekonomik, vendor”; neni 29 “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”. Neni 29/1, që na sjell qeveria, zoti Mjako, “Funksionet e bashkisë në fushën e diasporës” ka 4-5 pika. Çfarë ka këtu për të mos kuptuar koordinimin, germën “d”, që sapo e lexoi kolegu im? Çfarë thuhet në germën “d”? I thuhet kryetarit të bashkisë që do të koordinosh me ministrat përkatës për çështjen e diasporës, që do të thotë, që duhet të dish ligjin bazë për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, që të bësh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir, unë ju dëgjova, nuk ndërhyra kur folët ju. Unë jam relator, do të bëj koment për projektligjin, sepse jam relator dhe jam duke diskutuar për çështje serioze. Nëse nuk të pëlqen, nuk të pëlqen, por nuk mund të më ndërpresësh, sepse as unë nuk ju ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për procedurë merreni fjalën kur të mbaroj unë.

Pra, çfarë dua të them, zoti kryetar, e thashë në fjalën time, po e them prapë që ta kuptojnë më qartë, ky është një projektligj me 3/5-tat, me të cilin bashkive u shtojmë një funksion. Unë bëra sugjerimet teknike dhe profesionale, por po të doni, jam gati që të shikojmë ndonjë ndryshim të mundshëm për nenin 29, jo për dy pikat e tjera, se nuk kanë vlerë.

Të thuhet tani se ky është projektligj hipokrit, mua më duket absurde, hipokrit pse po ngremë zyra të diasporës në çdo bashki? Nuk e kuptoj ku është hipokrizia këtu. Prandaj, nëse ju nuk jeni të rakorduar vetë si opozitë si disa se disa, nga opozitarët tuaj votojnë në Komisionin e Ligjeve dhe janë dakord me projektligjin, dhe këtu po bëni pyetje hipokrite, mua më duket jo korrekte. Prandaj po ju lëmë kohë ta shikoni më qartë që kur të shikojmë në

seancë, ose në seancën që do ta diskutojmë nen për nen, të jeni ju të parët që do të thoni po duam ta bëjmë këtë, sepse kryetarët e bashkive nuk kanë ngjyrë, janë të gjitha forcave politike dhe zyrat që do të ngrihen do të ngrihen në çdo bashki, nuk do të ngrihen në bashkitë socialiste.

Pra, është e domosdoshme të bëhet kjo gjë, prandaj unë dua mirëkuptim. Nëse nga pikëpamja profesionale ka ndonjë gjë për projektligjin, ta bëjmë, që ta miratojmë dhe pastaj ta votojnë 140 deputetët, në të kundërt, nëse nuk doni ta votoni thjesht për politikë për të bërë opozitën, dakord, ne kemi edhe rrugë të tjera që mund ta bëjmë, por zoti Majko e ka sjellë në rrugë ligjore dhe të ndërhyjmë në ligjin që kërkon votim me 3/5. Ky është komenti që i bëj si relator. Pasi dëgjova disa pyetje që nuk më pëlqyen, të them të drejtën.

Ulsi Manja- Po, zoti Mjako.

Të japë përgjigje zoti Majko për pyetjet, pastaj mund të flisni ju.

Zonja Caka, ju lutem, zoti Naço është mbi 18 vjeç dhe flet vetë.

Nasip Naço – Unë jam edhe i përgjegjshëm. Nga ky moment, zoti kryetar, pyetjet do t'jua drejtoj juve dhe ju drejtojani kujt të doni. Unë mendoj se ministri është këtu, kur t'ia bëj pyetjet relatorit, të përgjigjet ai.

Ulsi Manja- Lexoni nenin e Rregullores, zoti Naço!

Nasip Naço – Cili nen i Rregullores e thotë që pyetjet i bëhen ministrit dhe përgjigjet relatori?

Ulsi Manja - Relatori ka të drejtën të japë përgjigje për çdo shqetësim.

Do të japë përgjigje edhe ministri.

Ulsi Manja- Zoti Majko, mund të vazhdoni

Pandeli Majko- Zoti kryetar, mendoj që ne po diskutojmë një projektligji, i cili kërkon një shumicë të cilësuar dhe që normalisht nuk mund të kalojë pa votat e opozitës. Vërejtjen e zoti Naço, lidhur me boshllëqet e relacionit, e konsideroj të vlefshme, ndaj do t'ju lutesha të më jepnit kohë, që t'ju ofroj të gjithë informacionin shtesë që kërkoi zoti Naço, ashtu siç ai kërkoi, që të jetë pjesë e relacionit. Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme edhe për seriozitetin e asaj që po diskutojmë, por edhe për seriozitetin e pyetjes së zotit Naço.

Ulsi Manja– A ka pyetje të tjera?

Nuk ka. A ka diskutime?

Po, zoti Mediu e ka fjalën për diskutim.

Fatmir Mediu – Duke u nisur edhe nga ajo që konstatoi relatori, kemi të bëjmë me një ligj që votohet me 3/5-t, dhe që kërkon nga ne si ligjvënës, kur ndërhyjmë në këto ligje, ta

shikojmë në kuadër më të gjerë sesa një aspekt të caktuar që ka të bëjë thjesht me migracionin.

Nëse flasim për ligjin e vetëqeverisjes vendore, bazuar mbi ato parime që u diskutuan këtu, siç është decentralizimi, qeverisja pranë qytetarëve, ne duhet të shikojmë realisht funksionimin e pushtetit vendor, sidomos duke konsideruar ndarjen administrative që u bë para disa vitesh. Le ta shikojmë realitetin ashtu siç është. Ndarja administrative, e cila u bë me një qëllim politik dhe elektoral, me një pazar njëditor, ku nga 40 bashki u bënë 61, sot në mënyrë të padiskutueshme është një vetëqeverisje vendore vetëm për një grup të caktuar qytetesh që jo vetëm nuk ka mundësi të merret me ata që janë në emigracion, zoti Majko, por nuk ka mundësi të merret me qytetarët e vet, sepse pjesa më e madhe e komuniteteve të fshatrave janë jashtë vëmendjes së kryetarëve të bashkive për një interes të thjeshtë qoftë ekonomik, qoftë elektoral të tyre.

Po ju bëj vetëm një analizë, të cilën mund ta verifikojnë të gjithë. Pjesa më e madhe e bashkive, mbi 95% e këshilltarëve i ka nga bashkia kryesore, as 5% nuk i ka nga zonat rurale, në një kohë kur popullsia, organizimi ynë demografik është krejt i ndryshëm. Kjo tregon mungesën e përfaqësimit dhe të interesit për një qeverisje të drejtë, afër qytetarit dhe bazuar mbi parimin që tha edhe zoti Fino. Ju, si ministër, por edhe ju si qeveri, duke qenë se jeni interesuar të keni një marrëdhënie më të mirë me migracionin, që të ketë sa më pak emigrim dhe që të kemi një shoqëri sa më vitale, duhet ta shikoni në një këndvështrim më të gjerë pikërisht organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore e të ndarjes administrative, e cila, në gjykimin tim, është një emergjencë kombëtare për ta analizuar dhe për ta shqyrtuar të gjitha forcat politike me një këndvështrim dhe qëllim të përbashkët.

Po flas për çështjen që ngrita, për emigrimin. Ju përmendët disa institucione që janë marrë me këtë çështje, si INSTAT-i apo *Friedrich Herbert*, por është edhe një sondazh i bërë nga *Galoop-i*, i cili ngre shqetësimin e madh që mbi 70% e shqiptarëve duan të largohen nga Shqipëria, të cilët ngrenë edhe shqetësimet e tyre në raport me atë pse duan të largohen, nga pamundësia për të ndërtuar të ardhmen e tyre ekonomike në Shqipëri. Nisur nga kjo, ne duhet patjetër të bëjmë edhe analizën tonë si shoqëri, si politikë, si ligjvënës. Në qoftë se pjesa më e madhe e shqiptarëve duan të largohen dhe sot largohen nga Shqipëria intelektualë, mjekë, inxhinierë, profesorë, infermierë, të rinj e të reja, duhet të shohim se çfarë po ndodh më shoqërinë tonë, e cila, për fat të keq, jo vetëm që po plakët, por edhe po mpaket. Është një shoqëri e cila po humbet vitalitetin e saj. Para disa vitesh ne kemi qenë shoqëria me moshën mesatare më të re në Europë. Sot po kalojmë në të kundërtën e saj. Duke bërë një analizë të kësaj situate, unë mendoj se ne mund të marrim një qëndrim më të drejtë edhe me propozimin

tuaj, edhe me pozicionin e ministrisë suaj, edhe me atë që duhet të bëjmë si ligjvënës për një zhvillim më të drejtë dhe më të qëndrueshëm në vend.

Unë e kuptoj kolegen Caka kur flet për hipokrizinë e këtij ligji dhe them se e tejkalon pozicionin tuaj si ministër apo portofolin e Ministrisë së Diasporës. Hipokrazia është se ne po i përzëmë shqiptarët dhe, në anën tjetër, kemi një ministri që po kujdeset për emigracionin apo për diasporën. E rëndësishme është që të mos i përzëmë, por të krijojmë mundësinë për ndërtimin e ekonomisë dhe lumturisë familjare në Shqipëri, një ekonomi të qëndrueshme që njerëzit të mos ikin, pastaj të kujdesemi, se ata mund të kthehen dhe të jetojnë në Shqipëri. Nuk mundet që të kemi një emigrim kaq masiv nga Shqipëria, pastaj të kemi mundësi për të kontribuar për ata që janë në diasporë, sepse do të vijmë në një pikë kur me këtë proporcion të zhvendosjes së popullsisë shqiptare drejt emigracionit, ministria më e rëndësishme e Shqipërisë ose qeveria e Shqipërisë do të jetë e diasporës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Mediu!

Për procedurë zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Për procedurë, do të kërkoj të ishim operativë edhe në komision, pasi analizën shkencore të ligjit e bëri në mënyrë shteruese dhe shkatërruese zoti Fino. Nisur nga ajo që u vendos në Komisionin e Jashtëm, si komision për dhënie mendimi, dua t'ju kujtoj përfaqësuesve të opozitës që në parim në Komisionin e Jashtëm kemi vendosur miratimin në parim edhe me votat e opozitës. Kështu që dua të di nëse jemi në këtë gjatësi vale. Sot kemi miratimin në parim të këtij projektligji. Kërkoj që të shprehen një herë në parim nëse janë dakord apo jo, apo kanë ndryshuar qëndrim dhe nuk janë konsekuentë më njëri-tjetrin, pastaj vazhdojmë analizën nen për nen dhe jemi të hapur e presim sugjerimet e tyre?

Fatmir Mediu – Një sqarim në parim: politika e diasporës, zoti Shameti, është politikë e jashtme apo politikë e brendshme?

Ulsi Manja – Ju lutem, e ka kërkuar fjalën për diskutim zoti Hyseni, pastaj do të shprehem në parim. Këtu janë këta dhe do ta shohim pas pesë minutash nëse janë në të njëjtën gjatësi vale me kolegët atje.

Zoti Hyseni, keni fjalën për diskutim.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Sjellja e këtij ligji për diskutim është një lajm politik. Prandaj unë gjej rastin të falënderoj ministrin për sjelljen e këtij ligji që nuk është thjesht një nga ligjet që po kalojmë, por është një ligj, i cili, në vijimësinë e politikave të qeverisë “Rama”, tregon një qasje

komplet tjetër, reale dhe institucionale të shtetit shqiptar ndaj pothuajse gjysmës së qytetarëve të këtij shteti, të cilët nuk jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kolegë deputetë, duhet të mos harrojmë që nga gati 4,5 milionë që jemi tashmë në regjistrat e këtij shteti, rreth 2 milionë nuk janë këtu. Kjo qeveri po përpiket të ngrejë disa institucione për këta 2 milionë. A është momenti që ne këtu të zihemi me njëri-tjetrin nëse duhen apo nuk duhen?! Prandaj këtu jo vetëm kolegët e maxhorancës, që jam i bindur se janë të gjithë në bllok pro kësaj ideje, që do të ndalet më vonë për formulime të tjera, por ftoj edhe opozitën të jetë e qartë dhe serioze. A është pro këtyre institucioneve? A është në favor të këtyre 2 milionë njerëzve, apo nuk është? T'i lënë këto pretekstet procedurale.

Të dashur miq, në biologjinë tuaj politike keni vetëm teorinë e krimit. Ngado që rrotulloheni keni mësuar vetëm krimbin që do t'ju sjellë në pushtet. Nuk është vetëm pushteti. Edhe në opozitë do të sillemi si shtetarë. Edhe ne do të vijmë një ditë në opozitë, por do të jemi të përgjegjshëm ndaj qytetarëve të këtij vendi atje ku na kanë dhënë mandatin, në opozitë apo në pushtet. Unë pres nga opozita që të marrë përsipër jo vetëm kaq, se ky është vetëm fillimi. Ne presim, tashme, prej muajsh tjetër gjë nga opozita. Ne presim nga opozita të shprehet nëse do t'ua japim emigrantëve të drejtën e votës apo jo.

Zoti relator, kjo është shumë e rëndësishme. Këto institucione janë minimale. Nëse ne kërkojmë t'u japim një strukturë në pushtetin lokal që do të kujdeset për ta, unë gjykoj se është minimumi që po bëjmë. Nëse ne do t'i japim kompetencë dhe mundësi pushtetit lokal që të organizojë veprimtari për emigrantët, ky është minimumi. Ajo për të cilën opozita duhet të përgjigjet shpejt, dhe e ftoj të vijë në diskutime, është t'u japë votën këtyre emigrantëve, pra që përfaqësuesit e këtyre 2 milionë njerëzve të jenë në këto komisione, në sallën e parlamentit, të ngrenë kartonin për ato që dëshirojnë për të përfaqësuar 2 milionë qytetarë, që nesër mund të jenë edhe më shumë, sepse kjo është shoqëria e globalizimit, ku e ardhmja ekonomike mund të ndërtohet kudo ku janë, e atdheut, e Shqipërisë. Nuk mund të na bëni ju moral ne, kur shumica e opozitës jeton jashtë vendit, duke filluar nga liderët e tyre. Nuk mund të na bëni ju moral neve, kur ju i arsimoni fëmijët tuaj jashtë vendit dhe ju na qenkeni ata që dëshirojnë të jetojnë këtu! Ekonomia ndërtohet aty ku është mundësia. Këto familje shqiptare që janë atje, pra këta 2 milionë njerëz kanë ditur ta ndërtojnë jetën mirë e bukur, madje e kam shprehur se ata janë shembulli se si i kanë tejkaluar edhe vetë qytetarët e atyre vendeve. Ky shembull duhet të na udhëheqë edhe ne si shtet që t'i tejkalojmë shtetet e tyre dhe të jemi në gjirin e shteteve të zhvilluara. Prandaj, le t'u lëmë kohë kolegëve të opozitës, të lëmë kohë edhe për rregullime teknike, nëse do të ketë nevojë, qoftë edhe vërejtje të caktuara, si edhe konsultime, por sot të shprehemi në parim. Pastaj të vijmë një ditë tjetër ta

miratojmë këtë ligj, i cili është minimumi i detyrimit tonë kushtetues ndaj çdo shtetasi shqiptar kudo që ndodhet, t'i përgjigjemi atij me institucione dhe jo më fjalë. Tashmë që ne vijmë me institucione, ju thoni që është propagandë. Si qenka propagandë?! Ne po kërkojmë të ngremë struktura të posaçme në pushtetet lokale, pra institucione, ju thoni se është propagandë. Kjo nuk është propagandë, të nderuar, ajo juaja është propagandë, sepse u shmangeni votimeve të rëndësishme, i shmangeni dhënies fuqi emigrantëve, sepse ju tremb vota e emigrantëve. Ju tremb, sepse, siç ju kanë kryqëzuar shqiptarët këtu, edhe më tepër ju kryqëzojnë emigrantët, sepse ata ju njohin shumë mirë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Reagime pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Naço, keni fjalën.

(Zoti Mediu flet pa mikrofon.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera... Unë të jap fjalën, ti pret zotin Mediu.

Ai e ka të fikur mikrofonin.

Nasip Naço – E respektoj unë edhe kolegun, edhe ju.

Faleminderit, zoti kryetar!

Po shikoj që ky projektligj ka ardhur me një relacion në formën e një telegrami. Ja tek e kemi dhe është gjysmë faqe. Të kalojë një projektligj me gjysmë faqe relacion! Ky është një telegram. Pra, qeveria ju bën ju, zoti Kryetar, pra Komisionit të Ligjeve, një telegram dhe ju kërkon ta kaloni dhe nuk pranoni as diskutime, as sugjerime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos e ngatërroni me projektligjin tjetër. Një nga parafolësit tha se projektligji është lajm politik. Unë jam i vëmendshëm dhe herë pas here mbaj shënime dhe konsultime. Sigurisht, është lajm politik, një lajm i mirë dhe do t'u shërbejë qytetarëve tanë që janë në botë, por, pavarësisht dëshirës dhe qëllimit të mirë për të sjellë një projektligj të plotësuar (dhe unë e mirëkuptoj zotin Majko), qeveria ia ka shkurtuar rrugës relacionin, duke menduar se kolegët e maxhorancës do ta kalojnë çfarëdo që të sjellë qeveria. Falënderoj zotin Fino që bën ndonjë koment pozitiv, por bën edhe ndonjë oponencë! Mjaftojnë gjysmat e fjalëve të zotit Fino për të treguar se ky projektligj është rrëzuar.

Ju faleminderit! Ta mbani dhe ta trashëgoni telegramin!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Fjalën e ka kërkuar zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë besoj se, pavarësisht pasionit me të cilin diskutojmë në këtë komision, çështjet e diasporës janë çështje që maxhorancën dhe opozitën duhet t'i bashkojnë dhe jo t'i ndajnë.

(Diskutime pa mikrofon)

A mund ta kem vëmendjen tuaj, zonja Silva, se ju dëgjova me shumë vëmendje?

Ulsi Manja – Zoti Naço, zoti Fino, të paktën kini respekt kur flasin kolegët, dëgjoni njëri-tjetrin, sepse për diasporën e di që ju digjet shpirti.

Dëgjoni kolegët këtu, sepse diasporën vetëm me shami e qani ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Jam në mes të fjalës, a të vazhdoj?

Ulsi Manja – Zonja Bushka, mund të vazhdoni.

Klotilda Bushka – Për kolegët që nuk më dëgjuan po thosha se çështjet e diasporës janë çështje që maxhorancën dhe opozitën i bashkojnë më shumë se sa i përçajnë. Kështu që mendoj se të gjithë këtu, pavarësisht diskutimeve që bëjmë, biem dakord me faktin se çdolloj nisme që u jep prioritet interesave të diasporës dhe i përkthen ato në interes publik shqiptar është një çështje që pranohet dhe është gjithëpërfshirëse. Në këtë kuadër, sigurisht që e vlerësoj nismën e ministrit që t'u jepet një asistencë e shtuar pjesëtarëve të diasporës në nivel lokal. Duke mos qenë në kundërshtim me atë që paraqiti relatori, zoti Fino, në lidhje me rezervat për sa u takon formulimeve përkatëse, për të cilat mendoj se kemi kohë t'i shohim gjatë diskutimit nën për nën të projektligjit, në këtë moment mendoj se me miratimin e strategjisë për diasporën, me ligjin për diasporën të miratuar vitin e kaluar, me krijimin e Agjencisë së Diasporës më në fund Shqipëria është duke bërë hapa konkretë përpara në kuadër të përfshirjes së interesave të diasporës në interesin përgjithshëm kombëtar të Shqipërisë. Diaspora nuk është e njëres parti, por është pjesë e kombit dhe e shtetit shqiptar dhe, si e tillë, unë mendoj se ne si aktorë politikë do të na duhet patjetër t'i kthejmë vëmendjen një çështjeje shumë të rëndësishme, që, në fakt, ia kemi borxh diasporës sot e 27 vjet më parë: votën e atyre që jetojnë jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë. Është pjesë e çështjeve të Komisionit të Reformës Zgjedhore. Komisioni i Reformës Zgjedhore e ka prioritet për ta diskutuar dhe për t'i dhënë një zgjidhje. Nëse nuk e bëjmë ne, kush do ta bëjë tjetër?! Kur them ne, e kam fjalën për maxhorancën dhe opozitën. Komisioni është ngritur dhe është në mes të punës. Nuk mbetet gjë tjetër veçse të ulemi në tryezë dhe t'i japim drejtim kësaj çështjeje.

Për ta mbyllur dhe për të mos u zgjatur, unë mendoj se do të jemi të gjithë dakord sot për ta miratuar në parim si projektligj. U kërkoj kolegëve të opozitës dhe maxhorancës që të

jemi konkretë në nismat për diasporën dhe të ulemi një orë e më parë në Komisionin e Reformës Zgjedhore për t'i dhënë drejtim jo vetëm çështjes së votës së emigrantëve, por edhe çështjeve të tjera që u takojnë proceseve zgjedhore, të cilat kanë mbetur pezull, në mënyrë që në zgjedhjet e ardhshme të jemi të gjithë të qartë se në cilin kuadër rregullator dhe mbi cilat shina ecën treni për një vend ku demokracia dhe zgjedhjet janë të shenjta dhe bëhen sipas standardeve ndërkombëtare.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Edhe unë bashkohem me mendimin e kolegëve që sot ta miratojmë në parim këtë projektligj, pastaj në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen t'u japim kohën kohën e nevojshme kolegëve të maxhoranës dhe të opozitës që të vijnë me propozime konkrete për ta përmirësuar ligjin. Ajo për të cilën biem dakord është fakti që ky projektligj ka ardhur në kohën e duhur dhe në momentin e duhur. Krahas ligjit për diasporën, qeveria ka menduar për të pasur edhe instrumentet e nevojshme për ta institucionalizuar këtë qëllim që ka: për ta bërë diasporën pjesë të vendimmarrjes sonë politike në Shqipëri. Shkojmë nga shkojmë, dihet që në fund fare në Shqipëri do të vijmë, se ky është atdheu ynë, ky është vatani ynë, këtu i kemi rrënjët dhe njeriu, në fund të fundit, është i lidhur me rrënjët. A kemi përgjegjësi ne të gjithë si klasë politike në këta 28 vjet me sjelljen tonë me diasporën dhe emigrantët?! Patjetër, e tha edhe ministri që kush më shumë e kush më pak, edhe ne kemi përgjegjësi tona. Nuk kemi treguar kujdesin dhe vëmendjen e duhur, por vjen një ditë, edhe për shkak të situatave që krijohen, edhe për shkak të fluksit të emigracionit, që sigurisht është për një jetë më të mirë, kur ne duhet të mendojmë seriozisht që pjesës sonë, ndoshta pjesës sonë më të mirë, që ka emigruar t'i krijojmë mundësi dhe kushte për të qenë e lidhur me shtetin amë.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji. Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Një kundër. Abstenim? Nuk ka. Dy veta nuk morën pjesë në votim.

Zonja Caka do të shpjegojë votën kundër.

Silva Caka – Zoti kryetar, unë jam i bindur se nuk ekziston njeri në këtë sallë kaq të vogël, duke filluar nga unë, por edhe të gjithë kolegët deputetë, sigurisht edhe këta zotërinjtë e nderuar që kanë ardhur të xhirojnë sot, si edhe përfaqësuesit e medieve, që të mos ketë të paktën, në mos familjar shumë të afërm, në rrethin miqësor apo në rrethin e njohjeve, një emigrant jashtë shtetit. Duke pasur këtë situatë në Shqipëri, të mos flasim për shifrat e frikshme të viteve të fundit, unë e votoj kundër këtë projektligj, sepse, siç e thashë edhe më parë, është hipokrit. Pse është hipokrit? Sepse unë jam e bindur që asnjërit nga ata, që sot nuk jeton në Shqipëri dhe ka ikur për arsye nga më të ndryshmet, nuk i intereson fare, ndoshta

gjëja e fundit në interes të tyre është të konsultohet për projektet e bashkive ku ka pasur origjinën. Emigrantët dhe diaspora kanë të tjera interesa, të cilat ju nuk morët mundimin as t'i dëgjonit dhe, duke mos i dëgjuar, sigurisht që ky projektligj i ardhur sot është i pabazuar në interesat e vërteta dhe në kërkesat e tyre. Kjo është arsyeja pse e votova kundër.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Falënderoj kolegët e komisionit. Me 12 vota pro, 1 kundër dhe dy që nuk morën pjesë në votim, miratohet në parim projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore””.

Zoti Majko, shumë faleminderit për prezencën në komision dhe për prezantimin e këtij projektligji të rëndësishëm!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.01.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Damian Gjikhuri, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Fatmir Mediu, Tom Doshi, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Silva Caka

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj

Të ftuar:

Rovena Voda- Zëvendësministre e Brendshme

Tomorr Duro - përfaqësues nga Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit

Renata Balliu- shefe sektori i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Silvana Dervishi- specialiste në sektorin e Marrëveshjes në Ministrinë e Brendshme

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Dua t'i uroj mirëseardhjen në Komisionin e Ligjeve kolegut tonë, deputetit Damian Gjikhuri. Unë shpresoj dhe besoj se përvoja e shkëlqyer e tij si jurist, por edhe eksperiencia e gjatë në menaxhimin e një prej ministrive më të rëndësishme, siç është Ministria e Energjetikës dhe Transportit, do të jetë një vlerë e shtuar për komisionin tonë.

Zoti Gjikhuri, mirë se erdhët!

Vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë”. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Relatore është kolegja Xhina. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Brendshme zonja Rovenë Voda, zëvendësministre, dhe stafi që e shoqëron atë.

Zonja Voda, ju lutem, bëni një prezantim sa më të përmbledhur të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit! Pastaj fjalën e ka kolegja Xhina.

Rovenë Voda – Faleminderit, kryetar!

Projektakti që kemi në shqyrtim “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë” synon forcimin e bashkëpunimit në fushën operationale. Marrëveshja është e fokusuar në tri shtylla kryesore: luftën kundër emigracionit të paligjshëm, krimit ndërkufitar, si dhe kryerjen e operationeve të kthimit dhe të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve.

Kjo marrëveshje e ngre në një stad më të lartë bashkëpunimin e strukturave të kufirit dhe migracionit me Agjencinë Europiane të Rojës Kufitare dhe Bregdetare. Ju kujtojmë se ka një eksperiencë të tillë midis këtyre dy strukturave. Me anë të kësaj marrëveshjeje synohet forcimi i bashkëpunimit në fushën operationale për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar, kryerjen e operationeve të kthimit e të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve, pjesëmarrjen në operatione të përbashkëta, por sigurisht edhe në trajnime të oficerëve tanë të kufirit dhe emigracionit, shkëmbimin e informacionit, si dhe në veprimet për operationet e kthimit dhe të ripranimit të emigrantëve të paligjshëm.

Dua t'ju them se kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme edhe në kuadër të procesit të integritetit të Shqipërisë në BE. Në një marrëveshje të nënshkruar në ministerialin e ministrave të Brendshëm të 5 tetorit të vitit 2018, kjo ka qenë një ndër detyrat kryesore në strategjinë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe më vjen mirë të them se Shqipëria është një ndër vendet e para që ka finalizuar këtë marrëveshje duke përmbushur edhe këtë

kriter apo këtë kusht në rritjen dhe forcimin e menaxhimit të integruar të kufijve midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së.

Bashkëpunimi midis strukturave tona të kufirit dhe migracionit dhe Frontex-it është një bashkëpunim që daton 10 vjet më parë, që nga vitet 2008-2009, ku për herë të parë kemi pasur të nënshkruar marrëveshjen në nivel teknik, ku oficerët e Frontex-it kanë pasur vetëm rol vëzhgues, ndërsa kjo marrëveshje e ngre në një nivel më të lartë statusin e bashkëpunimit midis këtyre dy strukturave.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Zonja Xhina, fjala për ju.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç u relatua edhe nga zëvendësministrja, ky projektligj ratifikoi marrëveshjen midis vendit tonë dhe Bashkimit Europian për kryerjen e aksioneve nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Europian në Republikën e Shqipërisë. Kjo marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit në fushën operacionale për të luftuar emigracionin e paligjshëm, krimin ndërkufitar, si dhe kryerjen e operacioneve të kthimit e të ripranimit në lidhje me menaxhimin e kufijve. Kjo marrëveshje krijon një kuadër rregullator për bashkëpunimin ndërmjet agjencisë dhe ekipeve të saj, nga njëra anë, dhe autoriteteve kompetente të vendit tonë, nga ana tjetër. Marrëveshja do të zbatohet vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila do të trajtojë dhe rregullojë detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit dhe personelit të Agjencisë, privilegjet, imunitetet, përjashtimet nga tarifat doganore e të tjerë. Meqenëse në aspektin ligjor kjo marrëveshje është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në aspektin procedural vjen në përputhje me Rregulloren e Kuvendit kërkoj nga kolegët që ta miratojnë atë.

Dua t'i bëj një pyetje zëvendësministres. Duke parë se kjo marrëveshje parashikon disa përjashtime lidhur me imunitetin penal apo civil të anëtarëve të ekipit tjetër, janë përjashtime që kanë një fushë goxha të gjerë, si në rastin e veprave penale gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe në rastin e shkaktimeve të dëmeve gjatë ushtrimit të detyrës, pyetja ime është: kjo marrëveshje tip nënshkruhet e tillë për të gjithë anëtarët, apo është një marrëveshje specifike për vendin tonë që përfshin këto përjashtime?

Pyetja e dytë lidhet me nenin 6, ku parashikohet se çfarë ndodh në rastet e kryerjes së veprës penale nga anëtarët e forcës ose anëtarët e ekipit tjetër. A është normale që në një marrëveshje të përcaktohet procedura se çfarë masash merren për kryerjen e një veprë penale

apo këta autorë “të dyshuar”, që mendohet se kanë kryer një veprë penale, do t’i nënshtrohen një juridiksioni penal, qoftë edhe të drejtës ndërkombëtare?

Faleminderit!

Ulsi Manja- Zonja Voda, fjala për ju.

Rovena Voda- Në fakt, kjo nuk është një marrëveshje specifike e bërë posaçërisht për Shqipërinë, por është një marrëveshje tip, në linjë të përgjithshme është e njëjtë me marrëveshjen që kanë vendet e BE-së me njëri-tjetrin. Pra, është ruajtur i njëjti standard.

Lidhur me pyetjen e dytë, ne, në fakt, kur kemi pasur negociata për të garantuar, në një farë mënyre për të mos u lënë dorë të lirë apo një imunitet të pakufizuar oficerëve të Frontex-it, jemi munduar dhe kemi bërë disa ndryshime, ndërkohë që në marrëveshjen tip ka qenë më e gjerë, por, duke qenë se ne jemi pak të ndjeshëm, pavarësisht marrëdhënies së shkëlqyer që kemi pasur me Frontex-in që nga viti 2008, një marrëdhënie 10-vjeçare bashkëpunimi, ne jemi munduar që ta kufizojmë disi. Këtu kemi bërë analogji edhe me ligje të tjera për imunitetin e diplomatëve të huaj, apo për agjencitë e UN, imunitete që parashikohen për punonjësit, ku kanë disa përjashtime të caktuara. Nëse do të shikohet me vëmendje, çdo veprim i anëtarëve të ekipit të Frontex-it do të bëhet në prani dhe me pëlqimin e ekipit vendas të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit. Ne kemi këmbëngulur gjithmonë për këtë, që do të thotë se pa pëlqimin e Departamentit të Kufirit dhe Migracionit dhe pa një plan pune të përbashkët të miratuar edhe nga ne, nuk ka shanse që të kryhen veprime operationale apo të përdoret arma e të tjerë. Domethënë, ne jemi zotër të këtyre operationeve, të cilat do të ndihmojnë flukset migratore. Për shembull, ne kemi një fqinj si Greqia, që është vend i BE-së, por e dimë shumë mirë që, për shkak të kufirit të gjelbër që ndajmë me të, flukset migratore të paligjshme i kemi pasur, pikërisht, me këtë vend. Kështu që me ardhjen e oficerëve të Frontex-it, pra ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, kjo do të jetë në fuqi të plotë dhe më pas do të vijohet me nënshkrimin e një marrëveshjeje pune të detajuar, e cila do të kalojë në një akt tjetër nënligjor. Edhe planet operationale, të cilat do të detajojnë çdo gjë, unë i shoh si vlerë të shtuar në kuadër të shtimit të flukseve migratore, por edhe në kuadër të situatës shumë kritike, duke filluar me rrugën e njohur Turqi- Greqi e të tjerë. Mjafton të jap si shembull vendin tonë fqinj, Maqedoninë, ku ka 164 forca të huaja policore, që kanë ardhur për të menaxhuar flukset migratore në kufirin, tashmë Maqedonia e Veriut, me shtetin fqinj grek.

Unë dua të them se deri tani jam krenare që policia jonë kufitare dhe migracionit është munduar ta menaxhojë situatën e flukseve migartore shumë mirë, por, duke pasur parasysh krizën edhe në vendet e Lindjes së Mesme, absolutisht, ne nuk kemi pse të gjendemi

të papërgatitur para kësaj situate dhe, njëkohësisht, duhet ta pranojmë këtu që është një interes i vendeve të Bashkimit European për të ruajtur kufijtë e tyre. Kjo vjen edhe për shkak se migracioni është një nga shtyllat kryesore, por që është i lidhur ngushtë edhe me fenomene të tjera të rrezikshme, siç është trafikimi i qenieve njerëzore apo terrorizmi, i cili, siç e dimë, është një problem që i ka shqetësuar të gjithë.

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Caka.

Silva Caka – Faleminderit!

Zonja Zëvendësministre, unë do të përpiqem që të ricitoj diçka që ju e thatë dhe, nëse gaboj, kërkoj ndjesë paraprakisht dhe dua një korrigjim nga ju. Nëse e dëgjova me vëmendje, ju thatë që në vitet 2008-2009 ne kemi pasur një bashkëpunim me Frontex-in, por nuk ka qenë në këto nivele, domethënë ka qenë diçka më e lehtë, ndërsa sot është forcuar ky bashkëpunim në nivele të tjera, të cilat tregojnë jo vetëm përfaqësimin e Frontex-it në vendin tonë me një sasi më të mëdha trupash, por edhe me kompetenca të reja, të cilat janë më të forta se ato që kanë pasur. A ishte ky thelbi i asaj që thatë ju?

Pyetja tjetër imja lidhet me këtë nivel kompetencash dhe përfaqësimi nga Frontex-i. Në dijeninë tuaj, marrëveshja e Frontex-it me vende që kanë kufij detarë, si: Mali i Zi, Sllovenia, Kroacia apo Greqia, a është e të njëjtit nivel me atë të Shqipërisë?

Faleminderit!

Rovena Voda – Është e vërtetë që unë thashë se marrëveshja e ngre në një stad më të lartë bashkëpunimin operacional midis Frontex-it dhe Departamentit të Kufirit dhe Migracionit, por për sa i përket kësaj marrëveshjeje, unë thashë që në fillim se kjo është e njëjtë. Domethënë, nuk është një marrëveshje specifike për Shqipërinë, por një marrëveshje e njëjtë që ekziston në të gjitha vendet e BE-së dhe vendet që përmendet janë vende të BE-së, të cilat e kanë me imunitet pak më të gjëra, për shkak se kjo agjenci vepron ndërmjet vetë vendeve të BE-së.

Për sa u përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, unë, në fakt, jo pa qëllim iu referova strategjisë së BE-së jo për Shqipërinë, por për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo strategji u shpall në shkurt të vitit 2018, ku një nga detyrat e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje ishte finalizimi i saj me të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Nga një takim që kam pasur me kolegë maqedonas, jam në dijeni se pas nesh do të jetë nënshkrimi me Maqedoninë dhe shumë shpejt me Malin e Zi. Në negociata janë Serbia, Bosnja, por pak më e vështirë për shkak të strukturës shtetërore që ka, dhe Kosova, për të cilën nuk jam e

informuar. Kjo është një marrëveshje që do të veprojë e njëjtë për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

Ulsi Manja- Zoti Naço, fjala për ju.

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se për këtë marrëveshje të rëndësishme duhet të ishte i pranishëm edhe ministri, por në mungesë të tij është deleguar zëvendësministrja.

Në relacion thuhet se kjo marrëveshje është propozuar nga Bashkimi European. Unë dua të di arsyen pse është propozuar nga Bashkimi European? Arsyeja është se ne nuk jemi të zotë të ruajmë kufijtë tanë, kemi mungesë profesionalizmi apo ka lidhje me korrupsionin në Ministrinë e Brendshme? Rojet bregdetare, të cilat do të vihen në kufirin bregdetar, a kanë lidhje me trafikun e lëndëve narkotike, siç është droga, ku në një njoftim të ditëve të fundit thuhet se në Shqipëri kapen vetëm 5% e trafikut të lëndëve narkotike?

Pyetja e dytë, e cila lidhet me citimin e një prej eksponentëve të rëndësishëm european, ku thuhet se në Shqipëri kapen vetëm 5% e lëndëve narkotike, rojet bregdetare do të jenë vetëm në kufijtë detarë, apo do të atashohen edhe në aeroportin ndërkombëtar të Rinasit?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja Voda.

Rovena Voda – Ju faleminderit për pyetjen!

Unë dua të them se pyetja juaj shkon kundër logjikës së agjencisë si strukturë, sepse kjo agjenci vepron ndërmjet vendeve të BE-së. Kjo do të thotë se Italia, Franca apo Gjermania i paskan kufijtë copë-copë, domethënë se ata nuk paskan mundësi të menaxhojnë kufijtë e tyre dhe kanë ngritur këtë agjenci?!

Kjo strukturë dhe kjo agjenci është ngritur për të koordinuar pikërisht menaxhimin e të gjitha veprimeve operationale në kuadër të menaxhimit të kufijve të jashtëm të BE-së të bazuar në tri shtylla kryesore, që, po t'i lexoni, janë të njëjtat shtylla që janë parashikuar në këtë marrëveshje, që janë: menaxhimi i emigrimit të paligjshëm; lufta kundër krimit ndërkufitar, por kryesisht kontrabandimit të emigrantëve, trafikimit të qenieve njerëzore, terrorizmit dhe shkëmbimit të informacionit. Nuk kishte asnjë mundësi që oficerët e Frontex-it të vinin të punonin me oficerët tanë nëse ata nuk do të kishin një nga procedurat standarde operuese.

Mua më vjen mirë që në shkurt të vitit 2018 kaloi me një vendim të Këshillit të Ministrave procedurat e reja standardet operuese, pra të veprimit të punës së Policisë Kufitare dhe Migracionit, të cilat janë në linjë dhe kanë pothuajse të njëjtin standard me policitë

kufitare dhe migracionit të vendeve të BE-së. Ligji për kontrollin kufitar, mbi bazën e të cilit operon Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, ju kujtoj edhe një herë, besoj se ju e keni ndjeshmërinë, sepse jeni edhe juristë, është një ligj i përafëruar me *acquire*-në e BE-së. Kështu që edhe VKM-ja për procedurat standarde është e tillë. Ju bëj me dije se prej disa kohësh në Akademinë e Sigurisë, ndoshta edhe e dini, ka një kurrikul 3-mujore të Frontex-it, mbi bazën e të cilës trajnohen, pra rriten aftësitë dhe kapacitetet e Policisë sonë Kufitare dhe Migracionit. Sigurisht, nëse nuk do të ishte kështu, nuk do të kishte si të pranonin, që të operonin, pra ti të operosh me një kolegun tënd kur ai nuk ka procedurat standarde të punës që ti kryen.

Dua të them se gjithmonë në operacione, sepse ndoshta duket si mburrje, por është një e vërtetë, dhe duhet t'ia themi këtë Policisë Kufitare dhe Migracionit, e përbashkëta apo trajnuese me oficerët të Frontex-it apo në vende të tjera të BE-së, gjithmonë kanë marrë vlerësimin maksimal për profesionalizmin e tyre.

Pse është propozimi i BE-së?

Së pari, është në strategjinë e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe migracioni i paligjshëm është shqetësim në BE. Këtë duhet ta pranojmë, për ata, në radhë të parë, por, sigurisht, edhe për ne, që jemi prekur nga flukset migratore vitet e fundit. Prandaj them se është vlerë e shtuar si marrëveshje. Pse të rrimë dhe të gjendemi para situatave kaotike, që ndoshta mund të jenë të vështira për t'u menaxhuar, kur ne mund të kemi mbështetjen e kësaj agjencie, me shumë eksperiencë, me njerëz shumë të trajnuar, me kapacitete logjistike shumë të fuqishme, që do të na shërbejnë edhe neve?

Për sa i përket rojës bregdetare, *counterparty* i Frontex-it këtu në Shqipëri do të jetë Departamenti i Kufirit dhe Migracionit. Në fakt, është një pyetje që u bë edhe në Komisionin e Sigurisë. Në ligjin "Për kontrollin kufitar", neni 5 e shpreh shumë qartë dhe përcakton si autoritet që kontrollon dhe mbikëqyr kufirin e Republikës së Shqipërisë Departamentin e Kufirit dhe Migracionit. Sigurisht, kur të jetë nevoja për të bashkëpunuar me Rojën Bregdetare, e cila është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe në njëfarë mënyre jam dakord me logjikën tuaj, ne kemi jo vetëm marrëveshje bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme me Ministrinë e Mbrojtjes, por, të mos harrojmë, kemi edhe një nukël, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, e cila është një qendër që koordinon punën e disa agjencive bashkë që, në fakt, është e rregulluar edhe me vendim të Këshillit të Ministrave. Por, po i kthehem edhe një herë, do të ketë një marrëveshje pune të detajuar, sepse një marrëveshje e detajuar pune nuk mund të jetë pjesë e kësaj marrëveshjeje që po ratifikohet këtu, do të jetë një marrëveshje pune që do të kalojë me VKM ose, nëse do ta çmojmë për

nga rëndësia, mund të kalojë edhe me ligj të veçantë, dhe ndoshta do të jemi përsëri do të jemi këtu, dhe gjithçka do të jetë e rregulluar në detaje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni, zoti Naço!

Nasip Naço – Ju folët për suksese të merituar të policisë, nuk e vë në dyshim konkluzionin tuaj. Kam një pyetje të thjeshtë: duke qenë se oficerët tanë janë kaq të mirë, kaq të shkëlqyer, sa keni propozuar për t'i dekoruar për këtë punë të mirë të shkëlqyer që bëjnë këta oficerët të Drejtorisë së Kufirit?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Naço!

Zonja Voda, kjo pyetje nuk ka lidhje me projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Voda, të lutem!

Mbledhjen e drejtoj unë këtu!

Policia e Shtetit shqiptar meriton të gjithë respektin tonë, sepse janë jo vetëm të trajnuar, por mos harroni, ka 28 vjet, se i kanë dhënë atdheut mbi 260 dëshmorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Naço!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

A keni diskutime?

Urdhëroni, zonja Caka!5

Silva Caka – Së pari, ardhja e kësaj marrëveshjeje është një lajm i mirë, sepse ka pozivitetin e saj, por në të njëjtën kohë është edhe lajm i keq.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Manja, i ka të dyja anët e medaljes. Është lajm i keq, sepse tregon që kufijtë e tu janë copë, me gjithë respektin për zonjën zëvendësministre, jo si kufijtë që përmendi, si Gjermaninë dhe Italinë. Kufijtë e Shqipërisë janë të shkatërruar nga migracioni i paligjshëm, nga trafikimi i lëndëve narkotike, nga paaftësia e strukturave policore për t'i menaxhuar, korrupsion dhe shumë arsye të tjera. Për këtë arsye, vjen një strukturë ndërkombëtare, e cila, meqenëse ti nuk rregullon dot shtëpinë tënde, po vijnë ta rregullojnë ata, sepse shkatërrimi i shtëpisë tënde, po sjell shkatërrimin e shtëpisë së tyre. Kështu që, ky është lajm i keq.

Meqenëse para zonjës Voda kishim zotin Majko, i cili nuk preferoi të jepte shifra dhe ta zbuste pak efektin e migrimit të paligjshëm, duke thënë se nuk është edhe aq keq, kjo

marrëveshje është konfirmim i situatë se sa keq janë kufijtë shqiptar. Për të gjitha arsyet që përmenda: migracion i paligjshëm, korrupsioni, trafiku i lëndëve narkotike, paaftësia për të menaxhuar kufijtë e të tjerë me radhë.

A është lajm i mirë?! Po, është lajm i mirë, sepse më në fund, do të jenë struktura shumë të specializuar dhe, sigurisht jo të formuara në Shqipëri, me ato konkursat e çuditshme që bënë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë apo Ministria e Brendshme, cila e ka në kompetencë për t'i organizuar. Këta janë oficerë policie shumë korrektë dhe sigurisht të trajnuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Nuk e di nëse ndonjëri prej këtyre ka hyrë në konkurs me pyetje të marra më parë. Ky është lajm i mirë. Sigurisht, vota pro këtij projektligji do të jetë edhe nga ana e Lëvizjes Socialiste për Integrim, por të mos harrojmë edhe një herë, arsyet pse ka ardhur ky projektligj, tashmë unë i bëra të qarta janë migracioni i paligjshëm, trafik i jashtëzakonshëm i lëndëve narkotike dhe paaftësi për të menaxhuar kufijtë tanë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Caka!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Voda!

Sinqerisht, të flasësh për marrëveshje që janë standard në Bashkimin Europian dhe që rregullohen me Rregulloren e BE-së që nga viti 2016, mua më duket alogjike.

Të nderuar kolegë të opozitës (flas për ju që diskutuat), në vitin 2008 Bashkimi Europian ka miratuar një direktivë për kthimin e personave të vendeve të treta në vendet e origjinës. Kjo direktivë është zbatuar nga Shqipëria edhe kur keni qenë ju në pushtet, edhe tani. Është detyrim. Ju e dini që ne kemi nënshkruar marrëveshjen e riatdhesimit.

Së dyti, në vitin 2016 Parlamenti Europian dhe Këshilli kanë miratuar një rregullore lidhur me Agjencinë e Rojës Bregdetare dhe të Kufirit Europian, dhe Kur BE-ja ka miratuar këtë rregullore, e cila zbatohet brenda vendeve të saj, por edhe për shtetet treta, dhe vendi i tretë jemi edhe ne që pretendojmë të bëhemi anëtarë të kësaj familjeje, besoj se është në dinjitetin e institucioneve shqiptare, në kuadër edhe të Ministrisë së Brendshme, për të zbatuar, pikërisht, këtë rregullore.

Ju thatë pse është kërkuar nga BE-ja. Po të lexojmë rregulloren, aty thuhet: “Rregullorja ka detyrimin të inkurajojë dhe të lehtësojë bashkëpunimin me vendet e tjera, që nuk janë ende vende të Bashkimit Europian” dhe ne pretendojmë të bëhemi vend i Bashkimit Europian, dhe pa dyshim është agjencia e cila ofron ndihmë, asistencë e të tjera.

Unë e vlerësoj këtë rregullore për katër arsye, që besoj se këto tregojnë rritjen e besimit të bashkëpunimi me policinë shqiptare në përgjithësi dhe atë kufitare në veçanti.

Së pari, kjo rregullore synon të rrisë nivelin e bashkëpunimit midis BE-së dhe vendin tonë. Besoj se të gjithë biem dakord që të gjithë që të rritet bashkëpunimi me BE-në.

Së dyti, besoj se të gjithë jemi dakord që policia shqiptare ka nevojë të rrisë aftësitë dhe trajnimin e saj. Pse duhet t'i themi jo një marrëveshjeje, e cila synon të rrisë nivelin profesional dhe trajnimin e punonjësve të policisë. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem, ju dëgjova kur folët dhe nuk ndërhyra!

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Caka, mos ndërhyri kur flet kolegia!

Zonja Hysi, mund të vazhdoni!

Vasilika Hysi – Më pas merreni fjalën për replikë dhe më kundërshtoni. *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Patjetër, sepse ju shkon si forcë politike që jeni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Së treti, çfarë tregojnë operacionet e përbashkëta? Tregojnë besim dhe reciprocitet. Nuk ka gjë më të mirë që Policia Kufitare Shqiptare dhe policia e Frontex-it, pra Frontex-i vetë do të kenë operacione të përbashkëta. Frontex-i nuk do të bashkëpunonte me një polici kufitare dhe do të shkëmbente informacion nëse nuk do të kishte besim. Pikërisht, këto 4 arsye, besoj se janë arsye të mjaftueshme për të na krijuar bindjen që kjo marrëveshje duhet ratifikuar.

Nga ana tjetër, të nderuar kolegë, mua më vjen keq, që edhe për këto marrëveshje, që kanë të bëjnë me forcimin e bashkëpunimit të autoriteteve shqiptare me mekanizmat e Bashkimit Europian dhe me agjencitë e Bashkimit Europian, ne përpiqemi të themi se ky është lajm i keq, t'i baltosim dhe të krijojmë një imazh që ky vend nuk e meriton dhe nuk duhet të bashkëpunojë me vendet e BE-së. Ju nuk keni qenë këtu, por pak më parë kemi miratuar edhe marrëveshje të tjera me *Eurojust-in* dhe *Europol-in* e të tjera. Vendet që kanë një bashkëpunim mes tyre janë vende, të cilat nuk janë në gjendje të mbrojnë kufijtë e tyre dhe të luftojnë krimin e organizuar brenda hapësirës europiane. Absolutisht që jo. Por, përderisa ne pranojmë të bëhemi pjesë e familjes europiane do të pranojmë të jemi pjesë e bashkëpunimit dhe të kemi nevojë për bashkërendim, kombinimin dhe asistencën e vendeve të agjencive të krijuara nga Bashkimi Europian.

I nderuar zoti kryetar, në këtë kuadër mendoj se duhet të ratifikojmë marrëveshjen dhe do të ishte mirë që kur të diskutojmë për marrëveshje të tilla, të cilat janë standarde të

mos përpiqemi të bëjmë politikë. Ka shumë çështje të tjera, për të cilat mund të bëhet politikë dhe mund të ketë shumë vend për kritika.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

A ka diskutime të tjera?

Urdhëroni, zoti Naço!

Nasip Naço – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht, nëse ka vend për të bërë politikë, sot është momenti i duhur për të bërë politikë, pra që të bëjmë politikë edhe ne përfaqësuesit e opozitës, sepse nuk jeni në ditët tuaja më të mira. Ne nuk jemi kundër që të bashkëpunojmë me institucionet e tjera të Bashkimit European, përkundrazi, jemi plotësisht dakord, por nuk jemi dakord për pjesën tjetër, që të vijnë ata dhe të marrin menaxhimin e kufijve. Kjo lë një shije të keqe për përfaqësuesit që kemi ne brenda strukturave të Ministrisë së Brendshme, për vetë qëndrimin që mbajnë këto struktura, të cilat nuk arrijnë dot që të ruajnë kufijtë e vendit të tyre.

Sigurisht, ju flisni për moral, flisni për mbështetje politike, na bëni gjyqin herë pas here.

Të nderuar kolegë të maxhorancës, më duket se një pjesë juaja e ka harruar vitin 2010, ju që një pjesë jeni këtu, që nuk keni votuar një sërë ligjesh. Për shembull, në dhjetor të vitit 2010 kërkohej votimi për liberalizimin e vizave. Pra, ju që jeni këtu, hapeni arkivën dhe do ta shikoni, po u drejtohem edhe medieve publikisht, nuk keni votuar asnjë nga projektligjet që shqiptarët të lëvizin lirisht në Europë, dhe sot dilni si heronj për të bërë një marrëveshje që nuk është marrëveshje bashkëpunimi, por është një marrëveshje kapitullimi midis strukturave të Ministrisë së Brendshme dhe strukturave të tjera të Bashkimit European për shkak të korrupsionit galopant, për shkak të trafikimit të lëndëve narkotike, të cilat kanë gjetur një shtrirje të gjerë në strukturat e Ministrisë së Brendshme, janë me dhjetëra drejtorë në kërkim, besoj se duhet të na fliste zëvendësministria, edhe për këta persona që janë në kërkim, të cilët janë ish-drejtorë të Policisë së Shtetit, që sot kanë marrë arratinë dhe nuk janë brenda këtyre strukturave. Pra, janë raporte të njëpasnjëshme, të cilat tregojnë qartë që Ministria e Brendshme në këto vite nuk ka funksionuar, është si godinë, por nuk ka funksionuar për të zbatuar ligjin. Prandaj e pyeta që në fillim zëvendësministren: kjo marrëveshje është propozuar nga ne, apo nga Bashkimi European? Sigurisht, zëvendësministria, por edhe në relacion thuhet se propozimi ka ardhur prej këtyre, sepse ju edhe ne bashkë, strukturat që kemi ngritur, që kemi menaxhuar nuk kanë qenë dhe nuk janë të afta për të ruajtur kufijtë e Shqipërisë.

Edhe një herë, të nderuar kolegë të maxhorancës, mos e harroni qëndrimin që keni mbajtur në vitin 2010, kur shqiptarët kërkonin që të mos rrinin më nëpër ambasada me ditë dhe me javë të tëra, por të lëviznin lirshëm në Europë. Ju të gjithë që jeni këtu keni votuar kundër të gjithë atyre projektligjeve, dhe është në memorien e këtij populli dhe këtij vendi që ju, të nderuar kolegë, nuk keni votuar në atë kohë, sepse një pjesë juaja dhe një pjesë e jona mund të përfitonte të merrte viza lirshëm, por qytetarët e tjerë rrinin me ditë dhe me javë të tëra dhe largoheshin nëpërmjet kufirit apo skafeve për të ikur për një jetë më të mirë. Mos e harroni sa herë që të kujtoni qëndrimin tonë, aq herë kam për t'ju kujtuar në këtë komision qëndrimin teje negativ që keni mbajtur në vitin 2010, kur u liberalizuan vizat për shqiptarët.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Naço!

Para se ta hedhim projektligjin në votim, fjalën e ka kërkuar zoti Braho.

Spartak Braho – Duke marrë pjesë edhe në komisionin përgjegjës, në Komisionin e Sigurisë, sepse komisioni ynë është komision për dhënie mendimi, unë vërej se përfaqësuesit e opozitës mbajnë një qëndrim të kundërt me atë që mbajnë deputetët e opozitës në Komisionin e Sigurisë. Ata e kanë votuar totalisht dhe çuditem që një marrëveshje e detyruar dhe që ndihmon monitorimet e kufirit të Shqipërisë, nuk votohet nga opozita.

(Diskutime pa mikrofon)

Prandaj ta votojmë dhe të mos e zgjasim kot me diskutime.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Braho!

Para se ta hedh në votim, kam edhe unë një fjalë për të thënë. Nëse opozita mendon se duke ia nxirë faqen Shqipërisë dhe duke hedhur baltë çdo ditë aty ku i jepet mundësia nga çdo foltore, se i shton vota apo i shtohet ndonjë fugon më shumë me protestues për në datën 16 shkurt, vazhdojeni dhe bëjeni, por shqiptarët e kanë ndarë mendjen, duan kufij të sigurt dhe duan integrimin në Europë. Ndërsa unë, si kryetar i Komisionit të Ligjeve marr përsipër që deri në datën 14 shkurt, që është dita e të dashuruarve, zoti Naço, dy ditë para protestës, të bëjmë mbledhje komisioni çdo ditë, që ju të keni mundësinë të bëni thirrje nga kjo tryezë e Komisionit të Ligjeve që të mbushni fugonët. Besoj se për këtë kam edhe mirëkuptimin e kolegëve të mi.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me këtë projektligj? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit European në Republikën e Shqipërisë”.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Së bashku me raportin përkatës t'i përcillet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare.

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Mbledhja e radhës do të jetë nesër. Rendi i ditës dhe ora do t'ju njoftohen nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA